



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 64

Datë: 21.11. 2017, ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.63/2017

2. Aktivitetet e SKQZ-së -(Raport nga QNR)

3. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur, kemi vetëm dy pika të rendit të ditës. A ka dikush vërejtje? Nëse jo, atëherë kush është për këtë rend të dite?

Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës. Në vazhdim të mbledhjes, u miratua procesverbalit nga mbledhja nr.63/2017.

2. Aktivitetet e SKQZ-së -(Raport nga QNR)

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Qendra e Numërimit të Rezultateve e ka gjithë materialin e ndjeshëm brenda në QNR, dhe është duke punuar në futjen e të dhënave të rezultateve, si dhe me skanimin e listave përfundimtare të votuesve. Para jush, e keni raportin me numrin e rezultateve. Po ashtu, e kemi në karantinë një pjesë të materialeve që nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta, dhe janë shkuar në karantinë me qëllim të hetimit dhe pastaj, për t'u numëruar në KQZ. Raport tjetër: e keni të bashkangjitur raportin e votave me kusht të personave me nevoja te veçanta dhe me postë, si dhe në fund kemi raportin e progresit nga futja e të dhënave nga formularët e rezultateve. Nga procedimi i të dhënave nga formularët e rezultateve, kemi 98.49% të formularit të rezultateve të procesuar në bazë të të dhënave që do të thotë se, kemi edhe pak vendvotime të cilat duhet të kompletohen nga komunitat e caktuara në mënyrë që t'i kemi 100% të kompletuara të dhënat e formuarit të rezultateve.

Skanimin e listës përfundimtare të votuesve, tha z. Ahmetaj, e kemi bërë 64% deri më tani të përfunduar, ndërsa proces tjetër që pritet të pasoj dhe të vazhdoj me ndërrimin në raundin e dytë, është regjistrimi i votave me kusht në bazë të të dhënave. Pra, të gjithë votuesit me kusht, regjistrohen në bazë të të dhënave. Pra, skanimi i listës përfundimtare të votuesve dhe regjistrimi i votuesve me kusht në bazë të të dhënave, bëhet me qëllim që të verifikohet ushtrimi i të drejtës së tyre votuese vetëm një herë, dhe jo më shumë. Të gjitha ato vota të cilat identifikohen që janë përsëritur më shumë se një herë, ato vota do të refuzohen, përndryshe, votat me kusht të cilat konfirmohen do të numërohen në QNR.

Jemi në proces dhe nuk mund të themi se mund të kryhet shumë shpejt, por sigurisht se do të na duhet edhe dita e nesërme që t'i kompletojmë këto dy procese, përndryshe, gjatë pranimit të materialit të ndjeshëm, janë diku 30 raste të cilat nuk kemi mundur t'i procedojmë si të rregullta për arsye të mospërputhjes gjatë procesit të pranimit. E keni tabelën para jush. Janë 8 raste të cilat nevojitet vendim i KQZ, të tjerat kanë të bëjnë me zarfet e fletëvotimeve me kusht, e që janë 22 zarfe të fletëvotimeve me kusht që duhet të anulohen se nuk kanë nënshkrime në listën me kusht. Pra, zarfet janë por, nuk janë nënshkrimet në listën e votimit me kusht. Rasti tjetër, është në komunën e Prizrenit. Është një vendvotim i cili, ka pasur mospërputhje. Po ashtu, edhe KKZ-ja e ka evidentuar s'i problem. Është fjala për vendvotimin 08A/01R. Pas hetimeve, është vërejtur se ka gabime dhe, rekomandohet KQZ që ky vendvotim të rinumërohet.

Të gjitha, tha z. Ahmetaj janë: 22 zarfe të fletëvotimit me kusht për anulim, dhe rasti tjetër është vendvotimi në Prizren për rinumërim. Ndërsa, në rastet e tjera, pas hetimeve është vërejtur se gjithçka është në rregull dhe se rekomandojmë që të procedohen s'i të rregullta. Neve, na nevojitet vendim për këto tri pika: për anulim, rinumërim dhe procedim të rregullt...

Valdete Daka: Ndonjë pyetje, a ka ndokush...? Nëse jo, atëherë kush është për miratimin e rekomandimeve të QNR ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e QNR-së.

Betim Gjoshi: Unë, i kam disa pyetje. E para, besoj se janë të gjitha përgatitjet për me filluar me u numëruar fletëvotimet me kusht. Kisha kërkuar nga QNR me i njoftuar subjektet politike në mënyrë që ata me i sjellë me kohë vëzhguesit dhe, rinumërimi me qenë sa ma transparent. E dyta, po e shoh se ka gabime, në shumë komuna sa u përket deklarimeve d.m.th., votave me kusht, është mirë për opinionin me e informuar se në formular kanë qenë të sakta, por që në sistem ka pasur gabim gjatë futjes se të dhënave. Edhe e treta, për mua është e rëndësishme që, të përgatiten rezultatet për asamblistë. Ka pasur përmbi 7000 kandidatë për asamble të cilët, presin rezultatet e fundit, dhe ka qenë mirë që ne të kemi raportet e fundit, dhe të procedohet sa më shpejtë në këtë drejtim sepse, duhet të themelohen pushtetet e reja. Pa i certifikuar asamblistët, kjo nuk mund të bëhet. Është mirë që nesër, t'i kemi rezultatet për asamblist nëse është e mundur...

Adnan Rustemi: Po, me këto çështje që u ngritën, edhe unë kërkoj të vërteten. Të merren masa të shtuara kur bëhet fjalë për transparencën maksimale: sa i përket numërimit të votave me kusht edhe kategorive tjera, në këtë rast të votuesve me postë edhe me nevoja të veçanta. Natyrisht, duhet shqyrtuar mundësinë me e krijuar hapësirën edhe për vëzhgues për me e vëzhguar operacionin që do të zhvillohet në QNR. Nga numërimi i vlerësimit, deri te futja e të dhënave deri në skanimin e listës votuese. Në ndërkohë, sa u përket votave me kusht, kërkoj që pas verifikimit të votuesve dhe në përputhje me procedurën e QNR-s për përputhje me listën përfundimtare, dhe me ata që kanë votuar në mënyrë të rregullt, të kemi informacione të detajuara për raportin që del nga verifikimi. Natyrisht, numërimi i këtyre votave të jetë me transparencë në mënyrë që procesi të mos jetë i kontestuar.

Binak Vishaj: Përveç se këto tema që u ngiten prej kolegëve, unë jam që QNR t'ua dërgojë planin e punës mediave, duke pasur parasysh se opinioni publik është shumë i interesuar për rezultatet nga votat me kush dhe jashtë vendit që, do të jenë edhe vota përcaktuese të fitores. Pra, të ftohen mediat, sidomos kur të bëhet numërimi për këto komuna që në mënyrë sa ma transparente të zhvillohet ky proces. Procesi të vëzhgohet nga mediat me kamera të hapura – drejtpërdrejtë, sidomos për tri komunat ku interesi i publikut për rezultatin nga numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe fletëvotimeve të tjera, është përcaktues...

Valdete Daka: Atëherë, a ka dikush ndonjë pyetje, sugjerim, diskutim..?

Adnan Rustemi: Po, kam një pyetje: po e shohë nga raporti i progresit ku janë futur 98% të formularëve... Kjo është mirë, por a ka mos përputhje...?

Burim Ahmetaj: Në QNR, në momentin që bëhet kompletimi i komunave, bëhet verifikimi duke krahasuar të dhënat nga rezultatet preliminare, dhe rezultateve të tanishme. Nuk kemi mospërputhje nga komunat të cilat janë kompletuar 100%, ndërsa ato që s'janë ende të kompletuara, nuk kemi bërë ende krahasimet që na nevojiten...

Adnan Rrustemi : Në auditim, janë vetëm 4 vendvotime, një në Gjilan, një në Klinë, një në Obiliq dhe një në Prizren... dhe, një del nja 6-7 komuna të cilat nuk janë kompletuar 100%...Kjo, është arsyeja sepse, nuk janë bërë krahasime në këto komuna...

Sami Hamiti: Asnjë komunë tjetër, përveç ato që i kemi rregulluar, e kam ulë diferencën, d.m.th., nuk ka tjetër askund...

Burim Ahmetaj: Në këto komuna të cilat i kemi verifikuar, nuk ka diferencë...Ato që nuk i kemi kompletuar, jemi në proces...

Sami Hamiti: Po ju lusë, dhe në këto komuna sqaroni këto votat me kusht se...!

Burim Ahmetaj: Sigurisht, kur të kompletohet i gjithë procesi, po mendoj të gjitha të dhënat nga gjithë formularët e rezultateve, do ta dimë saktë numrin e të gjitha votave me kusht...

Betim Gjoshi: Realisht, ne duhet të kemi kujdes sepse, kjo është pa dëshirën tonë. Në disa komuna, kemi rezultat të ngushtë edhe çdo informatë e rritë transparencën, e rritë besimin te publiku dhe kandidatët. Ne, duhet të përfshijmë transparencë sa më të madhe, duke përfshirë edhe mediat - televizionet që do të ishte mirë ta transmetojnë procesin e numërimit me kusht...

Valdete Daka: Do të njoftohen për këtë mediat me kohë. Të mos harrojmë se i kemi disa ankesa në PZAP, e që edhe nga ato do të varet dinamika e asaj se, si do të behet numërimi i votave me kusht, se varet se çka do të kthehet nga PZAP-ja...Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në mbledhje...Mediat do të njoftohen me kohë...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
